



**KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT  
INSTITUTI PARLAMENTAR**

---

**PROGRAM  
për pjesëmarrje në aktivitetin edukativ me  
temë:**

**“KAM QËNDRIM”**

*për nxënësit e  
shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Përmbajtjet për aktivitetin edukativ janë zhvilluar dhe realizuar nga Njësia për Edukim dhe Komunikim e Institutit Parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **Informacione të përgjithshme:**

Instituti Parlamentar është njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që funksionon si një qendër për hulumtim, edukim dhe informim, i themeluar mbi parimet e paanshmërisë, arritshmërisë dhe kredibilitetit.

Instituti Parlamentar, ndër të tjera, kryen aktivitete për edukim dhe informim të qytetarëve për punën dhe rolin e Kuvendit (në përputhje me qëllimin e tij strategjik për transparencën e Kuvendit ndaj publikut).

Në këtë drejtim, nga viti 2019, Instituti Parlamentar filloi me organizimin e punëtorive në formë të simulimit (loja me role) për nxënësit e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Idea për këto seminare u mor nga Parlamenti Federal i Konfederatës Zvicerane, i cili organizon aktivitete edukative me titull "My Point of View". Aktivitetit është program i veçantë i Njesisë për Edukim dhe Komunikim të Institutit Parlamentar që realizohet si një punëtori në kohëzgjatje prej tre orë. Aktiviteti është i dedikuar për nxënësit e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pjesëmarrja në "Kam qëndrim!" është kolektive, përkatësisht pjesëmarrësit paraqiten si grup nga shkolla, e jo në mënyrë individuale.

Çdo vit është planifikuar të organizohen 20 punëtori të këtij lloji. Punëtoritë zbatohen në dy cikle me nga dhjetë evenimente, ndërsa në çdo cikël marrin pjesë dhjetë shkolla. Çdo sezon i "Kam qëndrim!" (një seri prej dhjetë punëtorish) ka karakter garrues, respektivisht shkollat garojnë njëra me tjetrën duke simuluar një debat plenar në Kuvend. Debatet vlerësohen nga juria e përbërë nga tre anëtarë, duke përfshirë edhe deputetë/e të Kuvendit. Tre shkollat më të mira kalojnë në eventin final ku përballen njëra me tjetrën, me ç'rast juria e zgjedh fituesin e sezonit aktual. Shkolla që do të fitojë në sezonin aktual të "Kam qëndrim!" do të dekorohet me një trofe solemn të dhuruar nga Kryetari i Kuvendit.

## **Përshkrimi i punëtorisë "Kam qëndrim"**

Aktiviteti edukativ "Kam qëndrim!" paraqet simulim të procesit të shqyrtimit të propozim-ligjit në kuadër të Kuvendit. Pjesëmarrës në simulim janë nxënësit e shkollave të mesme të udhëhequr nga maksimum tre mësimdhënës - mentorë.

Për realizimin e aktiviteti nevojiten sërë përgatitjesh. Për këtë qëllim, paraprakisht kryhen konsultat e nevojshme me mësimdhënësit, në mënyrë që

të fitohen aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për zbatimin e aktivitetit dhe mentorimin e suksesshëm të nxënësve.

Aktivitetet në lidhje me realizimin e “Kam qëndrim!” fillojnë në shkolla tri javë para vizitës së Kuvendit. Nxënësit përgatiten nën udhëheqjen e mësimdhënësve - mentorë. Në fillim, mësimdhënësit - mentorë i ndajnë nxënësit në tre komisione dhe zgjidhen tri tema që do të diskutohen gjatë aktivitetit. Çdo komision shqyrton nga një temë. Pas zgjedhjes së temave, çdo nxënës mendon për temën e zgjedhur dhe nxënësve të tjerë të komisionit të tij / saj u jep propozime dhe argumente për zgjidhjen e problemit të zgjedhur politik. Çdo komisioni duhet të vendosë cilën zgjidhje do ta ofrojë para komisioneve të tjera dhe të punojë në përgatitjen e argumenteve me të cilat do ta mbrojnë zgjidhjen e tyre. Komisioni emëron një përfaqësues të komisionit (referues) i cili do të jetë përgjegjës para pjesëmarrësve të tjerë për të paraqitur zgjidhjen e ofruar. Mësimdhënësit - mentorë e vëzhgojnë zhvillimin e suksesshëm të aktivitetit.

Aktiviteti edukativ përfundon me mbajtjen e punëtorisë në Kuvend, ku bëhet simulimi i seancës plenare, ku pjesëmarrësit debatojnë dhe marrin vendime në lidhje me zgjidhjet e ofruara për të tri temat e përzgjedhura. Simulimi drejtohet nga një kryesues (i punësuar në Institutin Parlamentar), i cili është përgjegjës për ruajtjen e rendit të sesionit dhe dhënien e së drejtës për fjalë. Në fillim të debatit, referuesi para të tjerëve e prezanton zgjidhjen e ofruar nga komisioni i tij. Pas prezantimit, çdo nxënës ka mundësi të paraqitet për fjalë, me qëllim që të parashtrijë pyetje të caktuar ose të japë kundërgjendje. Qëllimi është që nëpërmjet prezantimit të argumenteve të bindshme, folësit t'i bindin kolegët së zgjidhja e tyre është e drejtë. Pasi të mbarojë lista e debatit, kryesuesi u bën thirrje pjesëmarrësve që të votojnë, ku shumica, në mënyrë demokratike vendos nëse zgjidhja është e pranueshme. I njëjti proces përsëritet në lidhje me dy temat e tjera.

Të gjithë pjesëmarrësve që janë pjesë e punëtorisë “Kam qëndrim!”, si dhe mësimdhënësve - mentorë, u jepet certifikatë për pjesëmarrje.

**Qëllimi i përgjithshëm**

**i punëtorisë:**

Afrimi i punës së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe procesi i miratimit të ligjeve të popullata e re, që do të kontribuojë në zhvillimin e ndërgjegjësimit të tyre për demokracinë dhe do t'i inkurajojë dhe përgatitë ata për kritikë dhe përfshirje shoqërore dhe politike

**Numri i pjesëmarrësve:** numri maksimal i pjesëmarrësve nga një shkollë është 40 nxënës dhe tre mësime; dhe;

**Koha:**

Cikli pranveror dhe vjeshtor,

**Vendi:**

Salla "Boris Trajkovski", Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

**Gjuha:**

Gjuha maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe;

**Trainues:**

Punëtorja do të realizohet nga trajnuesit e Njesisë për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar;

**Shpenzime:**

Pjesëmarrja në punëtori është falas dhe përfshin materiale edukative falas dhe pije freskuese gjatë punëtorisë. Shpenzimet e transportit nga dhe deri në vendin e punëtorisë i mbulojnë vetë pjesëmarrësit;

**Mënyra e**

**paraqitjes:**

Çdo shkollë që do të paraqitet, emëron maksimum 40 nxënës të cilët do të marrin pjesë në aktivitetet dhe tre mësime - mentorë. Paraqitja bëhet nëpërmjet platformës softuerike për paraqitje: [seminari.sobranie.mk](http://seminari.sobranie.mk)

**Kontakti:**

E-mail: [parl.inst@sobranie.mk](mailto:parl.inst@sobranie.mk)

tel: 02/3182 - 227

**Qëllimet e përgjithshme të punëtorisë:**

Në fund të punëtorisë, nxënësit:

- do të njihen me hapësirën në të cilën punon Kuvendi;
- do të dinë t'i identifikojnë kompetencat të Kuvendit dhe do të kenë pasqyrë të hollësishme për procesin e miratimit të ligjeve;
- do ta njohin punën e komisioneve në Kuvend;
- do të fitojnë njohuri më të gjera nga sfera dhe temat që diskutohen;
- do të fitojnë shkathtësi për debatimin me sukses dhe prezantimin e argumenteve të tyre;
- do të mësojnë sa është e rëndësishme arritja e kompromisit gjatë procesit të miratimit të ligjeve;
- do të kuptojnë çfarë do të thotë të jesh qytetar aktiv në shoqëri dhe si mund të kontribuojnë në proceset demokratike në vend.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, punëtorja do t'i përfshijë këto **përmbajtje**:

<b>Përmbajtje</b>	<b>Kohëzgjatja</b>
Vizitë e organizuar në ndërtesën e Kuvendit	60 minuta
Hyrje dhe instruksione për pjesëmarrësit	10 minuta
Simulim (loja me role) "Kam qëndrim!"	90 minuta
Vlerësim i punëtorisë dhe dhënia e certifikatave	20 minuta